

RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “ALBSIG”**SHKURT 2026****Emërtimi i Fondit:** Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension (“Fondi”)**Shoqëria Administruese:** Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.**Monedha Bazë:** Lekë**Politika e Investimit:** Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.**PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT****RREZIK I ULËT***Përfitime zakonisht të ulëta***RREZIK I LARTË***Përfitime zakonisht të larta*

1	2	3	4	5	6	7
----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

Të dhënat kryesore për Fondin më 28.02.2026


Vlera Neto e Aktiveve:	960.383.535,63 ALL
Çmimi për kuotë:	1.210,7277 ALL
*Kthimi nga Investimit (28 Shkurt 2025 - 28 Shkurt 2026):	4.10%

Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*KOSTOT DHE TARIFAT**

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emtuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	921,484,329.38	95.95
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	38,899,206.25	4.05

ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.


Kthimi vjetorë neto rezulton 4.10% për periudhën 28 Shkurt 2025 - 28 Shkurt 2026.

Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 2 vjeçare, 3 vjeçare, dhe 5 vjeçare deri më 28 Shkurt 2026. Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen. Fondi ka filluar aktivitetin në **07.02.2020**.

Albsig	5Y	3Y	2Y	1Y
	Norma Vjetore e Kthimit	3.48%	4.08%	4.18%